

# Pasqyrë e industrisë shqiptare të prodhimeve të detit

FRIEND OF THE SEA



# Pasqyrë e industrisë shqiptare të prodhimeve të detit

FRIEND OF THE SEA

---

<b>1. STRUKTURA DHE KARAKTERISTIKAT E INDUSTRIË</b>	03
1.1 PESHKIMI DETAR	03
1.2 PESHKIMI NË UJËRAT E BRENDSHËM	03
1.3 AKUAKULTURA	04

---

<b>2. SHFRYTËZIMI I PESHKUT TË KAPUR</b>	05
2.1 PËRPUNIMI DHE TREGTIMI	
2.2 KONSUMI I PRODHIMEVE TË DETIT	

---

<b>3. GJENDJA E BURIMEVE TË PESHKIMIT NË SHQIPËRI</b>	06
3.1 MENAXHIMI I PESHKIMIT	
3.2 GJENDJA E FONDIT TË PESHKUT	

---

<b>4. CERTIFIKIMI I MIKUT TË DETIT: MUNDËSITË DHE PËRFITIMET PËR TREGJET SHQIPTARE</b>	07
--	----

---

<b>BURIMET</b>	07
----------------	----

## 1.1 PESHKIMI DETAR



Peshkimi detar me kapje është sektori më i rëndësishëm i industrisë së peshkimit, por gjithashtu edhe peshkimi në laguna dhe në ujërat e brendshme është i konsiderueshëm. Prodhimi i peshkut të kapur në vitin 2014 ishte 5 730 ton, ku peshkimin detar përbënte 68% të totalit dhe pjesa tjetër vinte nga peshkimi në ujërat e brendshme.

Aktiviteti i peshkimit zhvillohet përgjatë të gjithë 476 km të vijës bregdetare të Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale të saj (12 milje nga vijat bregdetare bazë të saj). Megjithatë, aktiviteti i peshkimit përqendrohet kryesisht në raftin (cektësirën) kontinental, i cili nga ana e Adriatikut, në veri, shtrihet 25 milje, por në anën e detit Jon vetëm 2 deri në 4 milje. Nga pikëpamja e menaxhimit, ujërat e peshkimit në Shqipëri janë të vendosura sipas GFCM të FAO (Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun i Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë së Kombeve të Bashkuara) në nënzonën gjeografike 18 (GSA 18).

Flota shqiptare e peshkimit përfshin 584 anije (2014) dhe është e përqendruar në katër porte: Durrës, Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë, ndërkohë që Durrësi është më i madhi (me rreth 100 anije). Peshkimi detar shqiptar i përfshin të dyja, si flotën industriale ashtu edhe atë artizanale. Flotat industriale përdorin kryesisht barka peshkimi (peshkarexhë) me trata dhe rrjeta peshkimi, ndërsa peshkimi artizanal paraqitet me pajisje fikse dhe selektive të tilla si grepa, rrjeta fikse, trata peshkimi (ngjica) dhe rrjeta vertikale.

Rreth 40% e flotës janë anije të vogla me gjatësi më pak se 6 metra e me shumëllojshmëri pajisjesh. Anijet me gjatësi mbi 12 metra përfaqësojnë rreth 43% të anijeve të flotës. Mjeti kryesor i peshkimit është trata (rreth 38% e numrit të përgjithshëm). Peshku i kapur në vitin 2014 arriti në 5 813 ton, 35-40% i të cilëve ishin specie demersale (të fund detit), si merluc, barbun dhe karkaleca të ujërave të thellë, të cilat kryesisht janë eksportuar (pjesa më e madhe në vendet e BE) si peshk i freskët. Gjithashtu eksportohen sardelet dhe açugat.

## 1.2 PESHKIMI NË UJËRAT E BRENDSHMË



Shqipëria është një vend i pasur në burime të ujërave të ëmbla, me liqenet më të mëdha në Gadishullin e Ballkanit, me liqene artificiale, me lumenj të furnizuar nga shkrrjet e borës dhe shiu me karakteristika rrebeshi, duke siguruar një burim të bollshëm të ujërave të ëmbla dhe një bollëk rezervuarësh për përdorim bujqësor.

Në këto ujëra të brendshme (duke përfshirë edhe lagunat) ushtrojnë aktivitetin rreth 800 peshkatarë që përdorin rrjeta vertikale, rrjeta plazhi (bregu) dhe grepa.

**Prodhimi i peshkut të kapur në ujërat e brendshme të Shqipërisë në vitin 2015 ishte 1 482 ton.**

Peshkimi zhvillohet kryesisht në pesë liqene, katër prej të cilave janë liqene të mëdha ndërkufitare, ai i Shkodrës, i Ohrit, i Prespës së vogël dhe i Prespës së madhe. Një nga speciet më të vlefshme të peshkuara në Liqenin e Shkodrës është krapi.

## 1.3 AKUAKULTURA

Akuakultura aktualisht është një aktivitet i rëndësishëm për prodhimet e detit në Shqipëri dhe ka një potencial të madh zhvillimi në të ardhmen. Në vitin 2014 akuakultura prodhoi 2 424 ton, të përbërë nga peshq të ujërave të ëmbla, peshk detar dhe molusqe.


Tradicionalisht, akuakultura e ujërave të ëmbla bazohet në kultivimin e specieve të zakonshme ciprinide, të tilla si krapit i zakonshëm dhe krapit kinez. Salmonidet e ujërave të ftohta, kryesisht trofta e ylbhtë (*Oncorhynchus mykiss*) dhe korani (*Salmo letnica*) janë një grup tjetër i rëndësishëm në prodhimin akuakulturor intensiv dhe gjysëmintensiv në Shqipëri.

Ripërpunimi i *Salmo letnica* dhe i krapit të vogël indigjen në liqenet natyrore të tillë si Ohri dhe Prespa dhe në rezervuarët bujqësorë është gjithashtu një praktikë e zakonshme e akuakulturës në Shqipëri. Kjo praktikë ruhet nëpërmjet inkubatorëve Lini, ku riprodhimi artificial i *Salmo letnica* është kryer që në vitin 1965 dhe që aktualisht mban gati një milion larva dhe peshk të vogël çdo vit. Materialet e farës (larvat dhe peshqit e vegjël) prodhohen në sisteme të kontrolluara, duke filluar që nga vezët e grumbulluara nga mbarështimi natyral i peshqve në liqen nga peshkatarë të specializuar. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave është përgjegjëse për menaxhimin dhe mbështetjen financiare të inkubatorëve.

Sektori i akuakulturës është transformuar përgjatë viteve drejt specieve të reja të akuakulturës në ujërat detare, ndërsa kultivimi tradicional i cipriniditeve e ka humbur gradualisht rëndësinë. Sot, speciet kryesore të kultivuara e të prodhuara në Shqipëri janë trofta e ylbhtë (*Oncorhynchus mykiss*), levreku evropian (*Dicentrarchus labrax*), koca (*Sparus aurata*), krapit i zakonshëm (*Cyprinus carpio*), krapit kokëmadh (*Hypophthalmichthys nobilis*), krapit herbivor (*Ctenopharyngodon idellus*), krapit i argjendtë (*Hypophthalmichthys molitrix*), midhja evropiane (*Mytilus galloprovincialis*) e korani (*Salmo letnica*). Destinacioni i tyre kryesor është për konsum të brendshëm, me përjashtim të levrekut dhe kocës që eksportohen gjithashtu.

Aktivitetet e kultivimit të peshkut në kafazet detare janë të përqendruara në Detin Jon, ku 26 operatorë kultivojnë në fermë koca (*Sparus aurata*) dhe levrekun evropian (*Dicentrarchus labrax*). Inkubatorët për këto specie nuk janë të pranishëm në Shqipëri dhe peshqit e vegjël importohen kryesisht nga Italia dhe Greqia.

Kultivimi i midhjes mesdhetare (*Mytilus galloprovincialis*) është i përqendruar në lagunën e Butrintit në Sarandë, me disa aktivitete edhe në det të hapur në gjirin e Shëngjinit (rreth 100 ha me linja lundruese) me një prodhim vjetor prej 1 400 tonësh.



## 2.1 PËRPUNIMI DHE TREGTIMI



Në Shqipëri janë gjashtë kompani të përpunimit të peshkut. Katër prej tyre prodhojnë açuga, sardele dhe specie të tjera të vogla pelagjike për eksport, ndërsa dy të tjerat janë të specializuara për produktet e peshkut të ngrirë. Zhvillimi i sektorit të akuakulturës në vitet e fundit ka ndjekur kërkesën e konsumatorit të tregut të brendshëm të peshkut, sidomos për produktet e peshkut të detit (peshkut me fletë, jo molusqet). Për të mbuluar kërkesën e brendshme, Shqipëria importon produkte të akuakulturës detare, kryesisht levrek edhe koc nga Greqia. Importi i përgjithshëm i produkteve të peshkimit dhe akuakulturës arriti në 2 929 ton në 2014, dhe ka një rënie prej 50% nga viti 2010. Shumica e importeve vijnë nga Italia dhe Spanja; respektivisht 20% dhe 29%.

Vlera e eksportit të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës në vitin 2014 përbënte 42 milionë euro.

Destinacionet kryesore për eksportet shqiptare janë Italia (80% e vëllimit të përgjithshëm) e ndjekur nga Greqia (14%) dhe Maqedonia (2,5%), me açuga të përgatitura dhe të konservuara, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të eksporteve. Shqipëria nuk eksporton prodhimet e akuakulturës, me përjashtim të disa molusqeve të përpunuara (të marinuara), të levrekut dhe të kocit.

## 2.2 KONSUMI I PRODHIMEVE TË DETIT



Konsumatorët shqiptarë kanë preferuar tradicionalisht mishin dhe produkte të shpendëve, ndërsa peshku konsumohet në një masë të kufizuar e kryesisht në rajonet bregdetare të vendit. Përkundër kësaj, konsumi i produkteve të detit është rritur gradualisht dhe konsumi për kokë për vitin 2012 ka qenë vlerësuar rreth 5,5 kg/vit.

## 3.1 MENAXHIMI I PESHKIMIT

Drejtoria e Politikave të Peshkimit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është përgjegjëse për menaxhimin e sektorit të peshkimit. Instituti i Kërkimeve të Peshkimit në Durrës është përgjegjës për kërkimet në peshkim. Aktivitetet kryesore shkencore të Institutit janë vlerësimi i rezervave të peshkut, studimi i lagunave të Shqipërisë dhe i potencialeve e tyre dhe ripërtëritja e peshkut të vogël në ujërat e brendshme.

Kuadri ligjor i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës përfshin disa ligje dhe urdhëresa. Ligji kryesor që rregullon këtë sektor është Ligji Nr. 64/12 i vitit 2012 "Për Peshkimin". Shqipëria është në proces për t'u bërë një vend kandidat në Bashkimin Evropian (BE) dhe në këtë drejtim është gjithashtu në procesin e përafrimit të legjislacionit të saj me *acquis communautaire* të BE-së. Janë miratuar disa urdhëresa (akte nënligjore) që transponojnë disa nga parimet e politikës së përbashkët të peshkimit në legjislacionin shqiptar. Legjislacioni gjithashtu përmban parimet kryesore të Kodit të Sjelljes për Peshkim të Përgjegjshëm dhe ka filluar formimin e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit për ujërat detare dhe të brendshëm.

BE-ja po mbështet sektorin e peshkimit në Shqipëri me një projekt prej 2 milionë eurosh "Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes (MCS) së peshkimit në Shqipëri", i cili synon rritjen e kapacitetit të inspektorëve të peshkimit dhe instalimin e sistemit të pajisjeve të monitorimit të anijeve (VMS) në të gjitha anijet me gjatësi më të madhe se 12 m.

Sektori i politikave të peshkimit dhe akuakulturës, në kuadër të Drejtorisë së Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare është përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e sistemit të monitorimit dhe kontrollit për projektet e kërkimit shkencor që kanë të bëjnë me burimet e peshkimit në det.

Në mars të vitit 2003, Shqipëria aderoi në Konventën mbi Tregtinë Ndërkombëtare me Speciet e Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES).

Në qershor të vitit 2003 Shqipëria miratoi Konventën e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit (UNCLOS) të vitit 1982. Ajo është gjithashtu palë e Konventës së UNEP të 1976 për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Rajonit Bregdetar të Mesdheut (Konventa e Barcelonës). Shqipëria është anëtare e Komisionit Evropian Këshillimor për Peshkimin dhe Akuakulturën (EIFAAC), e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) dhe e Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Tonit të Atlantikut (ICCAT).



## 3.2 GJENDJA E FONDIT TË PESHKUT

Speciet kryesore të synuara nga flota shqiptare janë açuga evropiane (*Engraulis encrasicolus*), merluci evropian (*Merluccius merluccius*), barbuni (*Mullus barbatus*), karkalecat e kuq të ujërave të thellë (*Parapenaeus longirostris*) dhe sardelet evropiane (*Sardina pilchardus*).

Gjendja e rezervave vlerësohet dhe monitorohet nga FAO përmes GFCM-së dhe projektit AdriaMed. Përsa i përket gjithë detit Mesdhe, ka shqetësime në rritje lidhur me shfrytëzimin e tepruar të rezervave të peshkut. Pjesa më e madhe e rezervave të peshkut në Detin Mesdhe, duke përfshirë edhe ato të lartpërmendura, në fakt i nënshtrohet një peshkimi dhe frytëzimi të tepruar. Një reduktim i vdekshmërisë nga peshkimi është i nevojshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e peshkimit në rajon.



Sektori i akuakulturës shqiptare ka potencial për zhvillim në të ardhmen. Certifikimi i Mikut të Detit për operacione të qëndrueshme të kultivimit të peshkut mund të ndihmojë zhvillimin e industrisë shqiptare të akuakulturës drejt një baze të qëndrueshme.

Në fakt, Miku i Detit miraton vetëm metoda të qëndrueshme të akuakulturës që nuk bien ndesh me ekosistemin, duke përfaqësuar kështu një nxitje të rëndësishme për industrinë, që në aktivitetin e saj të respektoj mjedisin detar. Certifikimi mund të përmirësojë jo vetëm aspektet mjedisore, por edhe prodhimin dhe përfitimin, duke përmirësuar performancën e përgjithshme të industrisë.

Për më tepër, certifikimi FOS mund të ofrojë promovim ekologjik për aktivitetet tradicionale të peshkimit dhe akuakulturës, si p.sh. për roftën autoktone (koranin) *Salmo letnica* dhe krapin.

Nga ana tjetër, është e mundur që të parashikohen disa sfida për peshkimin shqiptar për të hyrë në certifikimin e qëndrueshmërisë, pasi rezervat kryesore janë tejmase të përdorura dhe tejmase të populluara, ose tejmase të peshkuara. Prandaj një reduktim i vdekshmërisë për shkak të peshkimit është i nevojshëm para se flota shqiptare të mund të certifikohet me sukses si e qëndrueshme.

## Burimet

Eurofish <https://www.eurofish.dk/index.php/albania>

Projekti FAO-AdriaMed. Projekti FAO AdriaMed 2018 - Web site. Informazioni sulla Pesca - ALBANIA: Lidhje [online]. Romë.

E përditësuar. [Cituar 24/1/2018]. [http://www.faoadriamed.org/italy/html/country\\_p/ALBCProfile.html](http://www.faoadriamed.org/italy/html/country_p/ALBCProfile.html)

Profillet e peshkimit dhe akuakulturës së vendit. Shqipëria (2015). Pasqyrë e profilit të vendit. Në: Departamenti i Peshkimit dhe Akuakulturës i FAO-s [Online]. Romë. E përditësuar më 2015. [Cituar më 23 janar 2018]. <http://www.fao.org/fishery/facp/ALB/en>

Pasqyrë përmbledhëse e sektorit kombëtar të akuakulturës. Shqipëria. Pasqyra përmbledhëse të sektorit kombëtar të akuakulturës. Teksti nga Cobani, M Në: Departamenti i Peshkimit dhe Akuakulturës i FAO-s [Online]. Romë. E përditësuar më 2015. [Cituar më 23 janar 2018]. [http://www.fao.org/fishery/countrysector/naso\\_albania/en](http://www.fao.org/fishery/countrysector/naso_albania/en)



**friendofthesea.org**



C.SO BUENOS AIRES, 45 20124 MILAN (MI) ITALY | TEL +39 02 87075166 | FAKS +39 02 73965029 | E-MAIL [INFO@FRIENDOFTHESEA.ORG](mailto:INFO@FRIENDOFTHESEA.ORG)